



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 261 / Prot.  
2

Tiranë, më 27.02.2025

**URDHËR**

Nr. 145, datë 27.02.2025

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 226, DATË 25.03.2019, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR MIRATIMIN E KONTRATAVE TË NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetues, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 7, shkronja “e” dhe “ë”, të ligjit nr. 111, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

**URDHËROJ:**

I. Në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në Shtojcën II “Kontratë për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 5, pika 5.2, nënparagrafi ix, ndryshohet si më poshtë:

“ix. Do t’i nënshtrohet dhe do të jetë i pranishëm gjatë monitorimit fillestar dhe të vazhdueshëm nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, do t’i paraqesë asaj informacionin e kërkuar në kuadër të monitorimit fillestar dhe të vazhdueshëm, si dhe do të paraqesë një raport në përfundim të punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.”

b) Nën neni 9, pika 9.2, ndryshohet si më poshtë:

“9.2. Kontraktori mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se Ofruesi i Shërbimit:

- a) shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Ligjin 111/2017;
- b) refuzon monitorimin fillestar dhe të vazhdueshëm nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
- c) mungon në mënyrë të përsëritur ose pa shkaqe të justifikuara, gjatë monitorimit fillestar dhe të vazhdueshëm nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
- d) në mënyrë të përsëritur ose pa shkaqe të justifikuara, nuk paraqet informacionin e kërkuar nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të monitorimit fillestar dhe të vazhdueshëm.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

III. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I DREJTËSISË**

  
**Ulsi Manja**

